

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

Nr./Br. 25678/23

Nr. i fq./ Br. sh. -4-

Data/ Datumi: 12.06.2023

VUŠITRI - VUČITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Komisioni Komunal i Aksionarëve i KRM "Uniteti" SH.A
Mitrovicë, Njësia në Vushtrri



Në mbështetje të Nenit 5.2 dhe Nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i shpallur në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës) me datë 15.06.2008, nenit 164 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës . Komisioni Komunal i Aksionarëve, K.R.M "Uniteti" Sh. A me datë 12.06.2022, shpall:

KONKURS PUBLIK (Për përzgjedhjen e anëtarit të Bordit të Drejtorëve)

I. Titulli: Anëtar i Bordit të Drejtorëve

Numri i ekzekutuesve: 1

Kohëzgjatja e emërimit: Për një periudhë tre (3) vjeçare

Përgatitja profesionale: Diplomë universitare.

Përvoja e punës: Së paku pesë (5) vite përvojë në nivel të menaxhimit

Koeficienti i pagës: Rregullohet në bazë të legjislacionit në fuqi .

KUALIFIKIMET DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

Sipas nenit 17, pika 17.3 të Ligjit për ndërmarrjet publike, një kandidat për t'u zgjedhur drejtor në Bordin e drejtorëve të NP duhet t'i plotësoj këto kushte:

- Duhet të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër;
- Duhet ose (i) të ketë së paku pesë (5) vite përvojë – në nivel të menaxhimit ose njohuri të cila ka të bëjnë me veprimtarinë afariste të NP-s .
- Duhet të jetë i pavarur gjatë ushtrimit të detyrave të anëtarit të Bordit.

PAVARËSIA E ANËTARIT TË BORDIT

Sipas nenit 17, pika 17.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike të gjithë drejtorët duhet të jenë të pavarur. Një person nuk konsiderohet i pavarur dhe nuk kualifikohet për zgjedhje si drejtor në një NP nëse:

- Nëse aktualisht është zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj, ose ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj brenda pesë (5) viteve të kaluara;
- Aktualisht është punonjës i nivelit të lartë i NP-së përkatëse, ose ka shërbyer si punonjës i nivelit të lartë në NP-në përkatëse brenda tri (3) viteve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tri viteve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste (përveç si konsumator individual i shërbimeve të NP-së) me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Aktualisht është aksionar, drejtor, zyrtar ose punonjës i lartë në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik i cili ka marrëdhënie materiale afariste me NP-në përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Nëse pranon, ose ka pranuar brenda tri (3) viteve të kaluara, kompensim shtesë nga NP përkatëse ose cilado nga filialet e saj (përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1, ose është anëtar në skemën pensionale të NP-së përkatëse ose cilëso nga filialet e saj);
- Mban drejtorësi të ndërsjellë ose ka lidhje të konsiderueshme me drejtorët e tjerë të NP-së përkatëse përmes përfshirjes në shoqëri tjera tregtare ose organe;
- Përfaqëson në aksionar i cili posedon dhjetë përqind (10%) të aksioneve votuese në NP-në përkatëse;
- Ka shërbyes në Bordin e Drejtorëve të NP-së përkatëse më shumë se nëntë (9) vite nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- Ai është i afërm i shkallës së tretë (siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të këtij ligji) i cilitdo person që i takon cilëso nga kategoritë më sipër përveç personit të përcaktuar në pikën (b); ose j) është ose (i) punonjës, zyrtar, drejtor ose aksionari, ose ka një Interes Financiar në, një shoqëri tregtare të palistuar dhe që konkurron me Ndërmarrjen, ose (ii) menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar (i cili posedon më shumë se dy përqind (2%) të të drejtave të votimit) i, ose ka një Interes të konsiderueshëm Financiar në, cilëndo nga shoqëritë tregtare të listuara që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- Ai është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike; l) ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktoje që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutine, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij fiduciare ndaj Aksionarëve dhe NP-së.
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Shoqëritë Tregtare, Ligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, si dhe ligjet të tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike.

Sipas nenit 17, pika 17.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike një person nuk mund të kualifikohet si drejtor nëse ka një të një nga mangësitë e cekura si në vijim:

- Një person që pretendon të bëhet anëtar bordi nuk duhet të jetë i dënuar ose vendosur nga një gjykatë kompetente, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë tjetër në bazë të ankesës, se ka kryer vepër penale ose civile vepër penale apo civile që përfshin përgënjeshtrimin, prezantimin e rrejshëm, korrupsionin, vjedhje, pastrimin e parave, përvetësimin, keqpërdorimin apo ndarjen e rrejshme të fondeve, ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipas ligjeve apo rregulloreve në fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas traktateve ose konventave ndërkombëtare;
- Nuk është vendosur nga një gjykatë ose organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e kodit etik apo standardeve të sjelljes profesionale, përveç nëse ky dënim ose vendim më pas është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër në bazë të ankesës (i) se është angazhuar në sjellje jo-profesionale, (ii) se ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, (iii) se ka keq-përvetësuar apo ka keqpërdorur paratë apo burimet publike, (iv) se keqpërdorur apo keq-përvetësuar informatat (të dhënat) e fituara gjatë shërbimit si zyrtar publik apo shërbyes civil, ose (v) se ka keqpërdorur postin publik ose postin në shërbimin civil për përfitime personale ose për përfitime apo përparësi të një të afërmi ose të njohuri; apo;
- nuk ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosur apo noterizuar;
- Nuk është shpallur i falimentuar gjatë dhjetë (10) viteve të kaluara

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës të antarit të Bordit të Drejtorëve:

- Merrë pjesë në miratimin e planit të biznesit, si dhe planin e buxhetit të ndërmarrjes për çdo vit kalendarik.
- Merrë pjesë në përcaktimin e lartësisë së tarifës për ofrimin e shërbimeve nga ndërmarrja;
- Merrë pjesë në miratimin e raporteve tre mujore dhe vjetore të punës së ndërmarrjes;
- Merrë pjesë në miratimin e pasqyrave vjetore financiare të bilancit, deklaratën e fitimeve dhe humbjeve të NP-së si dhe cilat do deklaratat tjera financiare që kërkohen me ligj, si dhe raportin vjetor mbi menaxhimin, politikën afariste dhe financiare dhe gjendjen industriale të NP-së.
- Raporton tek aksionarët për performancën e ndërmarrjes dhe pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative;
- Merrë pjesë në miratimin e rregulloreve të ndërmarrjes;

Aplikacionit duhet bashkangjitur:

- CV-në
- Një deklaratë nën betim të nënshkruar nga kandidati se i plotëson kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.1 dhe 17.2.

- Letër Motivuese;
- Dëshmitë për kualifikimin Universitar (Diploma të sillet e noterizuar);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është nën hetime dhe të sillet në formë origjinale (jo më e vjetër se 6 muaj);.

Konkursi mbetet i hapur pesumbdhdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën.

K.R.M Uniteti ofron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të të gjitha komuniteteve.

Konkursi është e hapur që nga 12.06.2023 – 26.06.2023 në ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë numër telefoni +383 45 603 645.

Vërejtje: Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë konkurs si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

Kryesues i Komisionit Komunal të Aksionarëve :

Benjamin Shala

